



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar Prilbjen/Prodato Received/Delivery | 16 - 11 2023 | 3 viti god year | |
| Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicima Quantity |
| SKANSHICK | 7013/2023 | | 1/5 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1242/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtar, dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1242/2023 të datës 03.10.2023 të parashtruar nga grup ankuesish [redacted] nga Gjakova, kundër Vendimit me Nr. 01-116/02-17264 të datës 30.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1242/2023 e datës 03.10.2023 e parashtruar nga grup ankuesish të përfaqësuar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesit [redacted] dhe [redacted] nëpunës të shërbimit civil në Komunën e Gjakovës me datë 21.06.2023 kanë parashtruar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj znj. T. Vokshi Udhëheqëses së Sektorit për Gjendje Civile në Komunën e Gjakovës tek Drejtori i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme me arsyetim se e njëjta bënë ofendime dhe shkelje të tjera të vazhdueshme ndaj stafit të punës, duke bërë edhe tejkalimin e kompetencave dhe ndërhyrje në komisionin e zyrës për Gjendje Civile për ndërrime dhe korrigjime të Gjendjes Civile etj.

Drejtori i Drejtorisë për Punë të Përgjithshëm Administrative në Komunën e Gjakovës me datë 02.08.2023 ka parashtruar kërkesën me numër 01-116/01-15275 tek Komisioni Disiplinor për fillimin e procedurës disiplinore ndaj Udhëheqëses së Sektorit të Gjendjes Civile me pretendim

për shkelje të rëndë disiplinore. Ndërsa Komisioni Disiplinor me date 30.08.2023 ka marr Vendimin me numër 01-116/02-17264 me të cilin e ka refuzuar kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshëm për Punë Administrative.

Ankuesit dhe të pa kënaqur me vendimin me numër 01-116/02-17264 të datës 30.08.2023, me datë 03.10.2023 kanë parashtruar ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se Udhëheqësja e Sektorit për Gjendje Civile në Komunë e Gjakovës, gjatë ushtrimit të detyrës ka bërë tejkalimin e kompetencave të saj ka paraqitur mungesë të profesionalizimit, ka bërë ndërhyrje dhe penguar personelin në kryerjen e punëve për të cilat janë kompetent dhe në mënyrë të përsëritur ka bllokuar dhe sjelle në lajthim punëtoret e shërbimit civil në Komunën e Gjakovës me këtë ju ka mohuar e drejta respektivisht ju ka humbur kohë qytetarëve duke i lënë pa shërbime për shumë kohë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.10.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Komuna e Gjakovës . Këshilli më datë 18.10.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Gjakovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6373/2023 të datës 03.10.2023 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin e datës 30.08.2023 të Komisionit Disiplinorë në Komunën e Gjakovës; Kërkesën e datës 21.06.2023 të parashtruar nga ankuesi tek Drejtori i Drejtorisë për punë Administrative; Aktvendimin me Nr.02-201/02-10773 të datës 25.05.2023; Vendimin me numër 02.nr.prot 201-02-9003 të datës 03.05.2023; Aktvendimin me numër NR.02-201/02-23405 të datës 02-201/02-23405 të datës 17.10.2022; Vendimin me numër 02.nr.prot 201-02-15243 të datës 23.06.2022; Emalin e datës 07.06.2023 të Sh. drejtuar K. ; Emalin e datës 07.06.2023 të S. drejtuar E. Vendimin e datës 30.09.2022; Dokumentet e identifikimit të ankuesve; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.10.2023; Përgjigjenin në ankesë të datës 11.10.2023; Akt emërimit nën shenjën AE.Nr.01-112/02-37385 të datës 13.12.2021; Akt emërimit nën shenjën AE.NR.01-112/01-1070 të datës 18.12.2022; Emalin e datës 02.08.2023 të J. drejtuar A. ; Kërkesën e datës 02.08.2023; Vendimin e datës 03.05.2023; Aktvendimin e datës 25.05.2023; Vendimin me numër 23.06.2022; Aktvendimin e datës 17.10.2022; Procesverbalin e seancës të datës 08.08.2023 të Komisionit Disiplinor; Emalin e datës 08.08.2023 të L. drejtuar D. ; Emalin e datës 08.08.2023 të L. drejtuar Q. Emalin e datës 08.08.2023 të L. drejtuar H. ; Emalin e datës 08.08.2023 të L. drejtuar K. Emalin e datës 08.08.2023 të L. drejtuar T. ; Emalin e datës 08.08.2023 të T. drejtuar L. ; Emalin e datës 08.08.2023 të L. drejtuar T. ; Emalin e datës 08.08.2022 të T. i drejtuar L. ; Emalin e datës 08.08.2023 të L. drejtuar T. ; Procesverbalin e datës 16.08.2023 të Komisionit Disiplinorë në Komunën e Gjakovës; Emalin e datës 26.05.2023 të K. drejtuar T. ;

Emalin e datës 25.05.2023 të T. drejtuar K. ; Emalin e datës 24.05.2023 të T. drejtuar K. ; Procesverbalin e datës 16.08.2023 të Komisionit Disiplinorë në Komunën e Gjakovës; Emalin e datës 16.08.2023 të H.Bejtullahu drejtuar L. ; Emalin e datës 26.05.2023 të E. drejtuar Kalaja; Emalin e datës 26.05.2023 të K. drejtuar T. ; Emalin e datës 25.05.2023 të T. i drejtuar K. Emalin e datës 24.05.2023 të T. drejtuar K. , Emalin e datës 24.05.2023 të T. drejtuar M. Emilin e datës 04.05.2023 të F. drejtuar M. ; Emalin e datës 17.08.2023 të H. drejtuar L. ; Emalin e datës 16.08.2023 të H. drejtuar L. ; Emalin e datës 19.08.2023 të F. drejtuar K. ; emalin e datës 30.08.2023 të R. drejtuar E. ; Vendimin e datës 22.07.2023; Aktvendimin e datës 17.10.2022; Vendimin e datës 23.06.2022; Emalin e datës 16.06.2023 të A. drejtuar H. ; Padinë e datës 11.05.2023 drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative; Ankesën e datës 24.10.2022; Ankesën e datës 16.11.2022; Emalin e datës 19.08.2022 të F. Koci drejtuar K. ; Vendimin e datës 22.07.2022; Aktvendimin e datës 17.10.2022; Vendimin e datës 23.06.2022; Padinë e datës 13.01.2023; Emalin datës 25.05.2023 të H. drejtuar B. aj; Emalin e datës 03.05.2023 të H. drejtuar K. ; Emalin e datës 01.07.2023 të A. drejtuar T. ; Emalin e datës 03.05.2023 të H. drejtuar K. ; Emalin e datës A. ri drejtuar T. ; Emalin e datës 16.08.2023 të H. drejtuar L. Vendimin e datës 22.07.2022; Emalin e datës 22.08.2022; Aktvendimin e datës 17.10.2022; Vendimin e datës 23.06.2022; Padinë e datës 11.05.2023; Vendimin e datës 22.07.2022; Aktvendimin e datës 17.10.2022; Vendimin e datës 23.06.2022; Padinë e datës 13.01.2023; Emalin e datës 25.05.2023; Emalin datës 03.05.2023 të H. drejtuar K. Emalin e datës 30.06.2023 të T. drejtuar H. ; Emalin e datës 01.06.2023 të A. drejtuar T. ; Emalin e datës 17.08.2023 të J. drejtuar A. Parashtresën e datës 17.08.20223; Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore të datës 20.01.2023; Kërkesën për fillimin procedurës disiplinore të datës 02.08.2023; Vendimin e datës 23.06.2023; Aktvendimin e datës 17.10.2022; Vendimin e datës 23.11.2022; Emalin e datës 30.01.2023 të T. ; Emalin e datës 07.12.2022; Emalin e datës 30.11.2022; Emalin e dates 03.03.2023 të T. drejtuar H. Emalin e datës 18.04.2023 të T. drejtuar H. ; Emalin e datës 19.04.2023 të T. i drejtuar Q. ; Emalin e datës 31.07.2023 të T. drejtuar Q. Vendimin me numër A.nr.957/2022 të datës 07.12.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Fmalin e datës 13.06.2023 të A. drejtuar H. ; Emalin e datës 13.06.2023 të H. drejtuar A. ; Emalin e datës 02.06.2023 të T. drejtuar A. ; Emalin e datës 28.02.2023 të T. drejtuar H. Dërgimin e dokumenteve të datës 09.03.2023: Emalin e datës 07.04.2023 të H. drejtuar E. ; Emalin e datës 27.04.2023 të H. drejtuar E. ; Emalin e datës 04.04.2023 të L. drejtuar H. ; Emalin e datës 07.04.2023 të H. drejtuar E. ; Emalin e datës 14.03.2023 të T. drejtuar B. ; Emalin e datës 13.03.2023 të T. drejtuar B. ; Emalin e datës 23.12.2022 të T. drejtuar B. ; Emalin e datës 22.12.2023 të T. drejtuar B. ; Emalin e datës 07.07.2023 të Sh. drejtuar K. ; Vendimin e datës 03.05.2023; Emalin e datës 16.06.2023 të E. drejtuar H. ; Padinë e datës 13.01.2023 të parashtruar në Gjykatën Themelore Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative; Emalin e datës 25.05.2023 të H. drejtuar B. ; Emalin e datës 01.06.2023 të A. drejtuar T. ; Aktvendimin e datës 25.05.2023; Vendimin e datës 03.05.2023; Procesverbalin e datës 30.08.2023 të seancës

përfundimtare te Komisionit disiplinore në Komunën e Gjakovës; Emalin e datës 31.08.2023 te L. Rogova drejtuar K.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesve, është e palejuar, sepse:

Ankuesit _____ dhe _____, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 01-116/02-17264 të datës 30.08.2023, të Komisionit Disiplinorë në Komunën e Gjakovës pretendojnë se vendimi i lartcekur përmbanë shkelje esenciale të dispozitave të LPA-së, vërtetim jo te plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueseve _____ dhe _____, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi, duke konstatuar se me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: *"Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative"*.

Se kush konsiderohet palë në procedurën administrative Kolegji i'u referuar nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative"*. Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimitimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: *"Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtari i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë"*, kështu që Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Vendimi me numër 01-116/02-17264 i datës 30.08.2023, të Komisionit Disiplinorë në Komunën e Gjakovës e që ankuesit e kanë kontestuar me ankesë nuk cenojnë ndonjë të drejtë apo interes juridik të ankueseve, gjegjësisht ankuesit nuk kane legjitimitetin e palës për të parashtruar ankesë kundër Vendimeve të lartë cekura, si rrjedhojë bazuar në këtë konstatim si dhe referuar nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e ankueseve konsiderohet se është pa pranueshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1242/2023.

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJKAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueseve
- Udhëheqësit të njësitit të detyrimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.